



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27 regjistër (JR)
Datë 20.05.2019

Nr. 20 i vendimit
Datë 08.09.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 08.09.2020, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 27/2019 (JR), datë 20.05.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Fatmir Lushi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 125, datë 26.03.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Fatmir Lushi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallë së Parë Elbasan. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në vlerësim të të dhënave për subjektin e rivlerësimit, grupi i punës ka konstatuar papërshtatshmërinë për ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në dy kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 125, datë 26.03.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në nenin 58, pika 1, shkronja “c” dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 125, datë 26.3.2019, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.*
7. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kritereve të vlerësuara.
 - 7.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit: i) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë e parë; ii) nuk ka bërë deklaram të saktë lidhur me pasurinë e dytë; iii) ka vepruar në kundërshtim me ligjin për sa i përket mbajtjes së gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar; iv) shpjegimet e tij për sa i përket vlerës së shpenzuar për pasurinë tokë “arë” me sipërfaqe 207 m², nuk janë bindëse dhe, për rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
 - 7.2. Në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nga vlerësimi tërësor i fakteve dhe rrethanave, të lidhura me përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive përmes favorizimit të çështjeve penale të hetuara, raportit të DSIK-së, të dhënave të besueshme, si dhe bindjes së brendshme, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

8. Më datë 08.05.2019, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 125, datë 26.03.2019, të Komisionit. Ankimi rezulton se është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe është nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.
9. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzion të ankimit të tij, kërkoi që shkaqet e ankimit t’i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:
 - 9.1 Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 125, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi.
 - 9.2 Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, vazhdimin e hetimit administrativ edhe për kriterin e tretë të procesit të rivlerësimit, që lidhet me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.
 - 9.3 Ndryshimin e vendimit nr. 125, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
10. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

Shkaqet procedurale të ankimit

10.1 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se vendimi i Komisionit është i gabuar, pasi është marrë vetëm për dy kritere të vlerësimit, kriterin e kontrollit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës. Komisioni nuk ka qenë në kushtet ligjore për të përfunduar hetimin administrativ pa u ezauruar të tria kriteret e rivlerësimit, duke shkelur kështu nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 6, pika 1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”).

10.2 Në lidhje me procesin e rregullt ligjor, subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit kalimtar, edhe pse është një proces administrativ, duhet të zhvillohet në përputhje me standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”). Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Komisionit, nuk përmbush standardet e gjykimit të çështjes në mënyrë të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

10.3 Subjekti pretendon se Komisioni në seancë dëgjimore relatoi të gjitha gjetjet që kishte shënuar në rezultatet e hetimit administrativ, pa iu referuar dhe vlerësuar asnjë provë apo pretendim të subjektit të rivlerësimit në prapësimet në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, dërguar Komisionit.

10.4 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Kolegji duhet të prishë vendimin e Komisionit për shkak se iu refuzua marrja si provë e dëshmisë së Oficeres së Policisë Gjyqësore M. K dhe këqyrja e dokumentacionit në funksion të procedimit penal nr. {***}, si prova të panevojshme.

10.5 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim që Kolegji duhet të gjykojë në seancë publike shqyrtimin e vendimit nr. 125, datë 26.03.2019, të Komisionit, me qëllim shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, si dhe vazhdimin e hetimit administrativ edhe për kriterin e tretë të procesit të rivlerësimit, që lidhet me aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.

Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

10.6 *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 102,94 m²*, ndodhur në rr. “{***}”, Elbasan, subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij pretendon se është i gabuar konstatimi i Komisionit sa i përket mosdeklarimit të burimit financiar për ½ pjesë të apartamentit, pasi babai nuk futet në kategorinë e personave të tjerë të lidhur. Në deklaratën *vetting*, sikurse e kërkon ligji nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka deklaruar burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, si për pjesën e tij, ashtu edhe për pjesën e z. M. L. Mosdeklarimi i burimit të blerjes së apartamentit ka ardhur si pasojë e pasaktësisë, pa pasur qëllim fshehjen e burimit financiar.

10.7 Subjekti i rivlerësimit pretendon se lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* për periudhën 2008 – 2012, ka dhënë sqarime si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ashtu edhe në seancë dëgjimore, sqarime të cilat kanë qenë bindëse përtej dyshimeve të Komisionit lidhur më shkaqet që kanë çuar në pasaktësitë në plotësimin e formularëve të deklarimit.

10.8 Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur mungesë të ardhurash për të justifikuar arredimin e apartamentit në vitet 2013 dhe 2014, në masën 50% të vlerës së arredimit, sikurse konstaton Komisioni. Vetë Komisioni në vendim, arsyeton se pas bërjes së analizës financiare, ku ishte përfshirë dhe vlera e arredimit për këtë vit, nuk ka pasur mungesë të ardhurash për të justifikuar arredimin e apartamentit në masën 50% për këtë vit.

10.9 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në zbatim të gabuar të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. M. L për blerjen e ½ pjesë të apartamentit në vitin 2013. Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit të rivlerësimit nuk është as në cilësinë e dhuruesit dhe as në cilësinë e huadhënësit apo huamarrësit. Gjithashtu, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohen si persona të tjerë të lidhur, ata persona të cilët kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga interesi pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

10.10 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit lidhur me mosdeklarimin e gjendjes *cash* në deklaratimet periodike para vitit 2012. Komisioni duhej të arrinte në përfundimin se nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe duhej të merrte në konsideratë nëse nga ky mosdeklarim ka pasur qëllim dashjeje në mosdeklarimin e gjendjes *cash*, si dhe faktin që këto likuiditete *cash* të padeklaruara vinin nga burime tërësisht të ligjshme.

10.11 *Lidhur me mosdeklarimin e pasurisë së shtetasit R. Sh*, subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimi i Komisionit për deklarim të pasaktë është i gabuar, pasi e ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike adresën e tij të banimit në banesën e dajës së tij, z. R. Sh.

10.12 Kontrata e energjisë elektrike është hapur nga autoriteti kompetent OShEE, ku abonenti nuk ka akses në vendimmarrje, bazuar në vetëdeklarimin për legalizimin e banesës në emër të z. R. Sh. Shkaqet për hapjen e kontratës së energjisë elektrike janë shpjeguar bindshëm, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit banonte në banesën e tij në Elbasan dhe nuk kishte të bënte me banesën e z. R. Sh, nga ku ishte larguar që në vitin 2015.

10.13 *Lidhur me pasurinë tokë arë, me sip. 207 m², në fshatin {***}, Tiranë*, me vlerë sipas kontratës 72450 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar që nuk bazohet në prova dhe në ligj, kur arsyeton në vendim se megjithëse konsideron referencën e parashikuar në VKM-në e vitit 2008, e cila ka vijuar të jetë në fuqi deri në blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, krijon bindjen se ka dyshime të arsyeshme, të cilat mbeten të pamundura për t'u provuar, me gjithë hetimin e thelluar se subjekti është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e kësaj pasurie.

10.14 *Lidhur me depozitën bankare, datë 22.02.2016, me afat 1-vjeçar*, në vlerën 1.500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ligji nr. 9049/2003 për mosmbajtjen e gjendjeve mbi 1,5 milionë lekë jashtë sistemit bankar, e lidh me subjektet të cilat deklarojnë për herë të parë, jo me subjektet të cilat bëjnë deklarime periodike. Edhe në këndvështrimin e nenit 4/1 të ligjit nr. 9049/2003, është përmbushur detyrimi ligjor, pasi shuma prej 1,5 milionë lekësh kursime *cash* të vitit 2015, është vendosur në bankë në datën 22.02.2016, ndërsa deklarimi i pasurisë për vitin 2015 është bërë në datën 18.03.2016, që do të thotë se depozitimi në institucionet bankare i gjendjes *cash* është bërë përpara dorëzimit të deklaratës.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

10.15 Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit Fatmir Lushi, në ankimin e tij, pretendon se nuk i është dhënë mundësia për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Duke mos e njohur subjektin e rivlerësimit me provën apo të dhënën që provon veprimtarinë korruptive të subjektit të rivlerësimit, nuk i garantohet e drejta për t'u mbrojtur dhe për të provuar të kundërtën. Subjekti pretendon gjithashtu se nuk i është bërë e ditur asnjë e dhënë apo informacion i disponuar nga Komisioni apo përmbajtje e së dhënës konfidenciale, të deklasifikuar, që lidhet me punën dhe figurën e tij si prokuror apo për përfshirjen në veprime korruptive.

10.16 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, që gjendet në zbatim të gabuar të ligjit, e justifikon duke cituar vendimin e GjEDNj-së Regner kundër Republikës Çeke. Komisioni nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor për të njohur subjektin e rivlerësimit me të dhënat që rezultojnë nga pjesët e deklasifikuara, me qëllim që t'i mundësohet subjektit të rivlerësimit provueshmëria e së kundërtës.

10.17 Subjekti i rivlerësimit pretendon se veprimet e kryera prej tij në kuadër të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016 të Prokurorisë Elbasan, së bashku me vendimmarrjen për pushimin e çështjes, ligjshmërinë e përgjimeve të realizuara për nevoja të këtij procedimi, si dhe asgjësimin e përgjimeve, janë kontrolluar dhe gjetur të drejta nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

10.18 Subjekti pretendon se të gjitha konstatimet e Komisionit, që ka evidentuar nga pikat 1.5 deri në 1.8 të vendimit përfundimtar, në lidhje me veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, që sipas ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë, shoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues të dosjes penale, si dhe me “Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ”, provojnë se konstatimet e Komisionit janë të gabuara, të pabazuara në prova dhe dokumentacion ligjor të dosjes penale.

10.19 Subjekti i rivlerësimit pretendon se qëndrimi i Komisionit është i gabuar kur arsyeton se subjekti nuk ka regjistruar në kuadër të procedimit penal nr. {***} edhe veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal, pasi Oficerja e Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”), në referimin e saj, shprehet se mendohet që ka elemente të veprës penale të mësipërme.

10.20 Subjekti i rivlerësimit pretendon se të gjitha konstatimet e Komisionit që ka evidentuar nga pika 2.1 deri në pikën 2.5 të vendimit përfundimtar, në lidhje me veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, që sipas ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë, shoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues të dosjes penale, si dhe me “Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ”, provojnë se konstatimet e Komisionit janë të gabuara, të pabazuara në prova dhe dokumentacion ligjor të dosjes penale.

10.21 Subjekti i rivlerësimit pretendon se bazuar në nenin Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe dorëzojnë një deklaratë të detajuar për figurën që i përket periudhës 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, ndërkohë që Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se procedimi penal nr. {***} është përpara datës 1 janar 2012.

10.22 Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit për kriterin e figurës është marrë në zbatim të gabuar të parashikimit ligjor të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi tërësor i këtij kriteri, bazuar në të gjitha dokumentet shoqëruese/justifikuese dhe në prova, subjekti pretendon se nuk rezultojnë të dhëna për cenim të besimit të publikut.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit, duke vendosur shkarkimin nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 125, datë 26.03.2019, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

13.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të pretenduar në ankim, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në apel, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Nuk rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit për t'u dëgjuar edhe në Kolegj. Kjo edhe për faktin se kërkitimi që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë publike nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu Kolegji kryesisht vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk vlerësoi se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

13.2 Kolegji, pasi e gjeti të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes, siç u përshkrua më sipër dhe duke qenë se as vetë kryesisht nuk konstatoi ekzistencën e ndonjë prej kushteve të parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, e cila parashikon rastet se kur një gjykim administrativ në Gjykatën e Apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike, vendosi ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi themelin e pretendimeve të shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi i Komisionit është i gabuar, pasi është marrë vetëm për dy kritere të vlerësimit, kriterin e kontrollit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës. Komisioni nuk ka qenë në kushtet ligjore për të përfunduar hetimin administrativ pa u ezauruar të tria kriteret e rivlerësimit. Provat e grumbulluara nga Komisioni kryesisht, si dhe provat e paraqitura nga subjekti, kanë provuar të kundërtën e asaj çka është konstatuar në raportin përfundimtar, ndaj duke paragjykuar çështjen Komisioni ka marrë vendim bazuar në hetimin e vetëm dy kritereve, duke shkelur kështu nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 6, pika 1 e KEDNj-së. Si rrjedhojë Komisioni duhej të riçelte hetimin administrativ dhe të vazhdonte procedurën e hetimit edhe për komponentin e tretë të vlerësimit, kriterin e aftësive profesionale.

14.1 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, Kolegji çmon se duke iu referuar kërkesave të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.* Pra, vendimi në procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kritereve të rivlerësimit, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative nga ana e Komisionit, ky i fundit arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit bazuar në rezultatet e arritura nga procedura për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit, dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kritereve të tjera.

14.2 Kjo vendimmarrje e Komisionit është e mundur të ndodhë vetëm në ato raste kur Komisioni çmon se gjendemi para kushteve të parashikuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016 dhe provat kanë një nivel të tillë të provueshmërisë që të bëjnë të besosh se jemi para prezumimit ligjor të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Pavarësisht vendimit që mund të merret në këtë fazë, për të mbyllur hetimin administrativ mbështetur vetëm mbi një ose dy kritere, Komisioni në funksion të zhvillimit të një procesi të drejtë e në respektim të së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar e mbrojtur, mundet ta revokojë këtë vendimmarrje pas kryerjes së seancës dëgjimore e analizës së pretendimeve të subjektit krahas provave të administruara nga hetimi dhe të vazhdojë procedurën hetimore administrative edhe për komponentët e tjerë. Ndërkohë që parashikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 kërkon që, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet detyrimisht të vlerësojë të tria kriteret në mënyrë kumulative. Në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016 është mirëpërcaktuar se me qëllim konfirmimin në

detyrë të subjektit të rivlerësimit, kërkohet që ai të plotësojë kushtet e kërkuara për të tria kriteret, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

14.3 Në funksion të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, del i qartë interpretimi që institucionet e rivlerësimit vendimin mund ta marrin mbi bazën e një kriteri vlerësimi ose të disa kriterëve, si dhe në vlerësimin e tri kriterëve apo në vlerësimin e përgjithshëm të tyre, ose në vlerësimin tërësor të procedurave të një ose disa kriterëve të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur në jurisprudencën¹ e Kolegjit. Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim, qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret dhe, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. *Ndaj shkaku i ankimit të subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.*

15. Subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit kalimtar edhe pse është një proces administrativ, duhet të zhvillohet në përputhje me standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”). Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Komisionit, nuk përmbush standardet e gjykimit të çështjes në mënyrë të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Në procedurën e ndjekur, si dhe nga vendimi i Komisionit, subjekti pretendon se dalin elemente paragjykimi dhe të një vendimi të paracaktuar, i cili vë në dyshim faktin nëse është gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur.

15.1 Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Kolegji arsyeton se procesi i rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së, rezulton se i është garantuar subjektit të rivlerësimit. Nuk konstatohet që subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit administrativ në Komision, të ketë ngritur pretendime në lidhje me procesin e rregullt ligjor. Neni 42, pika 2 e Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se: *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj* (dispozitë kjo në harmoni me KEDNj-në). Siç shtjellohet në paragrafët në vijim, kjo dispozitë kushtetuese nuk rezulton të jetë shkelur nga Komisioni në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.

15.2 Në analizë të dispozitave ligjore që rregullojnë të drejtat e palëve në proces neni 27 i ligjit nr. 84/2016 garanton të drejtat e palëve për një proces të paanshëm, për sa kohë që parashikon mundësinë e përjashtimit të një anëtari të trupit gjykues kur ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie, sipas nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Në këtë mënyrë i garantohet subjektit e drejta për të ngritur pretendime në raport me shkeljen e parimit të paanësisë në procesin e rivlerësimit, pretendime që subjekti nuk i ka ngritur në asnjë moment të procesit, por nuk i ngre as sot në ankimin e tij. Për këto shkaqe, Kolegji çmon se nuk gjenden shkelje të natyrës procedurale të kryera nga Komisioni në këtë drejtim.

¹ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44; nr. 11/2018 (JR), paragrafi 5; nr. 2/2019 (JR), paragrafi nr. 35.2; nr. 15/2019 (JR), paragrafi 119; nr. 34/2019 (JR), paragrafi nr. 55.1.*

16. Subjekti pretendon se në Komision, në seancën dëgjimore, u relatuan të gjitha gjetjet që kishte shënuar në rezultatet e hetimit administrativ, pa iu referuar dhe vlerësuar asnjë provë apo pretendim të subjektit të rivlerësimit në prapësimet në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ dërguar Komisionit. Gjithashtu, nuk gjendet asnjë shpjegim dhe arsytim në përmbajtje të vendimit përfundimtar të Komisionit në lidhje me pretendimet e subjektit për zbatim të gabuar të Kushtetutës dhe ligjit, si dhe vlerësimit të gabuar të fakteve dhe provave.

16.1. Në analizë të shkakut të mësipërm të ankimit, duke iu referuar materialeve që gjenden në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit është njoftuar për rezultatet e hetimit, duke i dhënë edhe mundësinë të japë shpjegimet e veta, duke i garantuar kështu të drejtën për t'u njohur me materialet në dosje, metodikën e përlllogaritjeve financiare, si dhe rezultatet e hetimit. Nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision, konstatohet se subjektit të rivlerësimit i janë respektuar të drejtat për një proces të rregullt dhe ligjor. Konkretisht subjektit të rivlerësimit në Komision, i është garantuar e drejta që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një organ i pavarur dhe i paanshëm. Vendimi i është komunikuar publikisht duke i dhënë më parë të drejtën për të paraqitur mendime dhe shpjegime për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, si dhe të depozitojë prova për të vërtetuar pretendimet. *Pretendimi i subjektit lidhur me këtë shkak ankimor nuk është i bazuar.*

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Kolegji duhet të prishë vendimin e Komisionit për shkak se iu refuzua marrja si provë e dëshmisë së Oficeres së Policisë Gjyqësore M. K dhe këqyrja e dokumentacionit në funksion të procedimit penal nr. {***}, si prova të panevojshme. Gjithashtu subjekti pretendon se nuk iu mor parasysh edhe raporti i audituesit ligjor lidhur me analizën financiare.

17.1. Kolegji vëren se Komisioni ka refuzuar të pyesë Oficeren e Policisë Gjyqësore, znj. M. K, për faktin se në raport me dëshminë e saj, vlerë të pakontestueshme ka referimi i bërë nga ana e saj, në procedimin penal. Subjekti i rivlerësimit nga ana tjetër kërkonte që nëpërmjet dëshmisë së OPGj-së do të shpjegohej jo përmbajtja e referimit të procedimit penal, por të gjitha veprimet hetimore të cilat janë kryer në lidhje me këtë procedim penal. Në dosjen e administruar nga Komisioni lidhur me procedimin penal nr. {***} të Prokurorisë së Elbasanit, konstatohet se fashikulli i procedimit përmban të gjitha veprimet hetimore që janë kryer në lidhje me zbardhjen e çështjes, dokumente këto të sjella edhe nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndaj nuk shihej e nevojshme që dëshmia e OPGj-së të jepej para Komisionit, pasi gjithçka në lidhje me hapat që janë ndjekur për kryerjen e veprimeve hetimore, gjendet në fashikullin e procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

17.2 Nga analiza financiare e Kolegjit, rezulton se raporti i auditit, i hartuar nga eksperti kontabël A. Q, me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, të cilin subjekti e ka dorëzuar në Komision, është bazuar vetëm në deklarimin e subjektit për krijimin e kursimeve të mundshme dhe jo në dokumente justifikuese, të cilat provojnë ekzistencën e këtyre kursimeve.

Ky raport është hartuar duke u bazuar në shpenzimet e përcaktuara nga Komisioni dhe të ardhurat nga paga të subjektit dhe bashkëjetueses së tij, të deklaruara nga subjekti dhe të konfirmuara me informacionin e institucioneve zyrtare. Eksperti kontabël ka konsideruar kursime diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve për secilin vit. Kjo metodë nuk rezulton të jetë në përputhje me deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke qenë se këto kursime nuk janë deklaruar nga subjekti i

rivlerësimin në deklaratat periodike të pasurisë dhe gjithashtu, sipas kësaj analize, do të rezultonte me një shumë *cash* në vitin 2014 më të madhe se ajo që ka deklaruar.

Sa më sipër, shkaku i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk është i bazuar.

Analizimi i shkaqeve që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë

18. *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 102,94 m², me nr. pasurie {***}, fituar me kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 26.08.2013, me vlerë 5.056.412 lekë, me adresë: lagjja “{***}” rr. “{***}”, Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konstatimi i Komisionit sa i përket mosdeklarimit të burimit financiar për ½ pjesë të apartamentit, pasi në deklarimin periodik vjetor të vitit 2013, subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar interesat privatë të tij dhe të personave të lidhur, ku futen bashkëshortja/bashkëjetuesja dhe fëmijët madhorë dhe jo për z. M. L. (babai i subjektit) që nuk futet në këtë kategori. Z. M. L. përmendet në deklarim për shkak të të qenit bashkëpronar në këtë pasuri. Në deklaratën *vetting*, sikurse e kërkon ligji nr. 84/2016, subjekti pretendon se e ka deklaruar burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, si për pjesën e tij, ashtu edhe për pjesën e babait të tij. Mosdeklarimi i burimit të blerjes së apartamentit ka ardhur si pasojë e pasaktësisë, pa pasur qëllim fshehjen e burimit financiar. Në këtë mënyrë janë plotësuar edhe deklaratat periodike para vitit 2013.*

18.1. Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Kolegji arsyeton dhe vëren se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë: *Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme, apartament, me nr. {***} rep., nr {***} kol., datë 26.08.2013, e lidhur përpara noteres A. L, midis palës shitëse A. Q dhe T. Q, si dhe blerësve Fatmir Lushi dhe M. L. Pasuria e paluajtshme ndodhet në Elbasan, me nr. pasurie {***} z.k. {***} vol. {***}, faqe {***}, me sipërfaqe 102,94 m², me adresë pallati {***}, sh.a, k. {***}, ap. {***}, lagjja “{***}”, rruga “{***}” Elbasan. Apartamenti është blerë në pjesë të barabartë me babain tim M. L dhe Q. L, lëshuar më 03.09.2013. Për pjesën në pronësi të Fatmir Lushi (gjysma), burimi i krijimit, kursime nga të ardhurat nga paga si prokuror dhe paga e bashkëjetueses si mësuese. M. L (si person tjetër i lidhur) ka bërë një deklaratë në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi me Fatmir Lushin. Kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur vërtetime të Njësisë Administrative {***}, Elbasan, për pagën si mësues të z. Fatmir Lushi (djali) dhe pagën si infermiere të znj. D. L (vajza). I ka bashkëlidhur vërtetime të DRSSH Elbasan, së bashku me kopje aktesh, për z. M. L dhe znj. Q. L, si dhe vërtetim të lëshuar nga DAMT Elbasan për trajtim me tokë bujqësore.*

18.2 Në deklaratën e interesave privatë periodike (në vijim “DIPP”) të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *Blerje apartamenti, në bashkëpronësi 50% me 50% me M. L. Blerja është kryer më datë 26.08.2013. Kontrata e shitblerjes mban nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., Apartamenti ka një sipërfaqe prej 102,94 m². Adresa: lagjja “{***}” pallati {***}, shk. {***}, kati {***}, ap. {***}, Elbasan. Zona kadastrale nr. {***}, nr. pasurie {***}.*

18.3 Siç rezulton nga DIPP-ja e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi, të cilin e ka në bashkëpronësi me babain e tij M. L. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar burimin e krijimit të këtij apartamenti. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të deklaruar burimin e krijimit

të pasurisë, e pasqyruar kjo edhe në formularin e deklaramit të pasurisë. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte burimin e krijimit të pasurisë në deklaratën periodike të vitit 2013. Në këto rrethana, meqenëse është vetëm një deklaram i pasaktë në deklaratën periodike, Kolegji vlerësoi se kjo pasaktësi, nëse qëndron e vetme, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* për periudhën 2008 – 2012, ka dhënë sqarime si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ashtu edhe në seancë dëgjimore, sqarime të cilat kanë qenë bindëse përtej dyshimeve të Komisionit lidhur me shkaqet që kanë çuar në pasaktësitë në plotësimin e formularëve të deklaramit. Këto pasaktësi nuk kanë pasur asnjë qëllim apo motiv. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar plotësisht dhe saktësisht pasuritë e tij, pasi të ardhurat janë të ligjshme.

19.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me konstatimin e Komisionit për mosdeklarimin e gjendjes *cash*, ka sqaruar se këto pasaktësi nga subjektet e rivlerësimit edhe për raste të tjera precedente në Komision, kanë ardhur si pasojë e mungesës së përvojës, trajnimeve apo informacionit të nevojshëm për plotësimin e deklarameve periodike.

19.2 Kolegji vëren se në deklaratat periodike të vitit 2008, kur subjekti i rivlerësimit fillon të deklarojë për herë të parë përpara fillimit të detyrës, dhe deri në vitin 2014, nuk ka deklaruar në asnjë nga rubrikat e deklaramës periodike kursime *cash* në banesë apo në llogari bankare. Subjekti ka paraqitur në Komision një raport auditimi të hartuar nga një ekspert kontabël i pajtuar nga subjekti i rivlerësimit. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur po të njëjtat përlllogaritje që ka kryer edhe eksperti kontabël. Nga studimi dhe analizimi i këtij raport auditimi, rezulton se është përdorur e njëjta metodologji për përlllogaritjen e shpenzimeve si Komisioni, por në përlllogaritjet e tij, audituesi ka vlerësuar mundësinë e kursimit sipas shpjegimeve të subjektit. Në deklaramet e subjektit deri në vitin 2014, nuk është deklaruar në asnjë vit gjendja e llogarive bankare. Nga këto llogari, nuk ka pasur ndonjë grumbullim të likuiditeteve për t'u pakësuar në vitin 2013 kur është kryer blerja e apartamentit në qytetin e Elbasanit.

19.3 Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij bën një analizë të situatës së tij financiare, duke zbritur nga të ardhurat shpenzimet e jetesës, shpenzimet e transportit dhe shpenzimet për blerje pasurie. Në llogaritjen e tij nuk përfshin në asnjë vit gjendjen e llogarive bankare. Këtë analizë subjekti e bën nga tetori i vitit 2006 deri në gusht të vitit 2013 dhe, sipas tij, ai edhe pse s'ka deklaruar në asnjë vit kursime nga diferenca e të ardhurave me shpenzimet, pretendon se ka arritur të kursejë vlerën 4329.983 lekë. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, sipas standardeve të konsoliduara tashmë, në funksion të këtij shkaku ankimi ka rezultuar se në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit nuk mund të përballonte shpenzimet e jetesës, shpenzimet e arredimit dhe shpenzimet e tjera të vitit dhe gjithashtu të mund të kryente pagesën e 50% të vlerës së apartamentit në qytetin e Elbasanit nga të ardhurat e ligjshme të këtij viti. Kjo, pasi subjekti i rivlerësimit për këtë vit dhe në vitet paraardhëse, nuk ka deklaruar asnjë burim tjetër të mundshëm për t'u përdorur për blerjen e kësaj pasurie.

19.4 Në referim të ligjit nr. 9049/20013, varianti i pandryshuar, në nenin 4, shkronja “d” parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në

ILDKP vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve. Pasaktësitë që subjekti justifikohet në shpjegimet gjatë hetimit administrativ, sipas dokumentacionit në dosje, rezultojnë se shoqërohen me mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, ndaj nuk konsiderohen si të tilla pikërisht për shkak se përfaqësojnë në fakt mungesë burimesh financiare të krijimit të pasurisë së ligjshme.

Sa më sipër, shkaku i ankimit të subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka pasur mungesë të ardhurash për të justifikuar arredimin e apartamentit në vitet 2013 dhe 2014, në masën 50% të vlerës së arredimit, sikurse konstaton Komisioni. Ky i fundit nuk arsyeton në vendim mbi metodologjinë që e ka çuar në këtë konkluzion. Vetë Komisioni në vendim arsyeton se pas bërjes së analizës financiare, ku ishte përfshirë dhe vlera e arredimit për vitin 2013, subjekti nuk ka pasur mungesë të ardhurash për të justifikuar arredimin e apartamentit në masën 50%.

20.1 Kolegji vëren se Komisioni ka dalë në përfundimin se subjekti nuk ka pasur mundësi për të përballuar vlerën e mobilimit për vitin 2013, duke qenë se analiza e Komisionit është kryer për vitin e plotë, jo të ndarë në dy periudha. Subjekti i rivlerësimit e ka ndarë në dy periudha analizën financiare të tij.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e arredimit të këtij apartamenti në pyetësin standard të Komisionit, ku kjo vlerë deklarohet afërsisht 1 400 000 lekë, e investuar në pjesë të barabarta, nga të ardhurat e familjes së tij dhe të babait. Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur pranë këtij institucioni në datën 18 shkurt 2016, se: *Vlera mesatare e shpenzuar për mobilim është rreth 300 000 lekë për dy vitet 2013, 2014.*

20.2 Nga analiza financiare e kryer në Kolegji lidhur me këtë shkak ankimi, rezultojnë se duke mos pasur një periudhë të saktë se kur mund të jetë kryer mobilimi i banesës në qytetin e Elbasanit, analiza për shpenzimet e jetesës, shpenzimet e arredimit dhe shpenzime të tjera bëhet e plotë për një vit kalendarik. Duke u krahasuar me fluksin e të ardhurave për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit rezultojnë se nuk kishte mundësi të përballonte shpenzimet, përfshirë arredimin dhe të krijonte pasuri nga të ardhurat e tij të ligjshme, duke qenë se nga analiza financiare rezultojnë me një diferencë negative në vlerën 1 823 604 lekë. Nga kjo analizë financiare e Kolegjit, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet për arredimin e apartamentit dhe krijimin e kursimeve edhe për vitin 2014 nga të ardhurat e këtij viti, për një diferencë negative në vlerën 69 596 lekë.

Sa më sipër shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi me sip. 102,94 m², nuk është i bazuar në ligj e në prova, pasi nuk u arrit të shpjegohet bindshëm burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë dhe i të ardhurave në përputhje me nenin D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit, në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, është i drejtë.

21. Subjekti i rivlerësimit, përsëri nëpërmjet ankimit, pretendon se Komisioni, në zbatim të gabuar të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. M. L për blerjen e ½ pjesë të apartamentit në vitin 2013. Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit të rivlerësimit nuk është as në cilësinë e dhuruesit dhe as në cilësinë e

huadhënësit apo huamarrësit. Gjithashtu, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, përcakton si persona të tjerë të lidhur ata persona, të cilët kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga interesi pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

21.1 Kolegji çmoi se në analizë të dispozitave të cituara në shkakun e ankimit, përcaktimet e bëra në nenin 3, pika 14, janë referime që duhet të përdoren për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, por edhe për t'u përdorur nga institucionet për të përcaktuar e parandaluar gjendjen e konfliktit të interesit, krahas legjislacionit të posaçëm që rregullon situatën e konfliktit të interesit për zyrtarët.

21.2 Në të njëjtën linjë me këtë arsytim, shkon edhe analiza e rregullit të vendosur në shtojcën nr. 2, që shoqëron ligjin nr. 84/2016, sipas së cilës: *Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Personat e tjerë të lidhur, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo dispozitë duket se qëndron në harmoni me parashikimet që bën neni 3, pika 11 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", sipas së cilës: *Person i lidhur me një zyrtar është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.**

21.3 Në analizë të kësaj situate ligjore, duke vlerësuar dhe vendimmarrje² të mëparshme, Kolegji ka çmuar se përcaktimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në funksion të deklarimit e verifikimit të çdo situate të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-ja (shih nenin 33, pika 5, germa "d" e ligjit nr. 84/2016), ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit, edhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur kryesisht duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

21.4 Në këto kushte, Kolegji vlerëson se, pavarësisht disa rrethanave të konstatuara, siç është burimi i krijimit të pasurisë nga babai i subjektit të rivlerësimit, këto rrethana mund të sqaroheshin vetëm nëpërmjet një hetimi të thelluar, të legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi. Të gjendur në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre dyshimeve, vlerësohet se verifikimi i mëtejshëm i tyre kapërcente kufijtë e objektit të procesit të rivlerësimit. Duke

² Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, paragrafët 107, 108, 109.

arsyetuar në këtë mënyrë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet e panevojshme të hetohet më tej për burimin e krijimit të gjysmës së pasurisë që i përket babait të subjektit të rivlerësimit. *Sa më sipër, shkakut i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i bazuar.*

22. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit lidhur me mosdeklarimin e gjendjes *cash* në deklarimet periodike para vitit 2012, i cili duhej të arrinte në përfundimin se nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së tij. Komisioni duhej të merrte në konsideratë nëse nga ky mosdeklarim ka pasur qëllim dashjeje në mosdeklarimin e gjendjes *cash*, si dhe faktin që këto likuiditete *cash* të padeklaruar vinin nga burime tërësisht të ligjshme.

22.1 Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Kolegji arsyeton se proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuar me njëri-tjetrin.

22.2 Nga dispozitat ligjore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, vërehet se ato i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga organet e rivlerësimit, i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara.

22.3 Në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimt ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”. Po në nenin 4, pika 7, parashikohet: “E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.” Në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, te “Barra e provës”, parashikohet: *Komisioni dhe Kolegji i Apelimt në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit.* Sipas dispozitës në fjalë, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Referuar gjetjeve të evidentuara nga Komisioni, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, është rrjedhojë direkte e parashikimeve ligjore.

22.4 Nga analizimi i këtyre dispozitave kuptohet se proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit. Sipas vlerësimit të Kolegjit, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka gjykuar bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, pasi në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit, rëndësia e shkeljes është e tillë që nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

22.5 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se në vitin 2013 subjekti nuk mund të përballonte shpenzimet e jetesës, shpenzimet e arredimit dhe shpenzimet e tjera të vitit dhe gjithashtu të mund të kryente pagesën e 50% të vlerës së blerjes së apartamentit në qytetin e Elbasanit nga të ardhurat e vitit 2013, nga paga, duke qenë se subjekti për këtë vit dhe në vitet paraardhëse nuk ka deklaruar asnjë burim tjetër të mundshëm për t'u përdorur për blerjen e kësaj pasurie.

22.6 Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 102,94 m², ndodhur në Elbasan, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e kësaj pasurie, pasi rezultoi e provuar se ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në vitet 2013, 2014 në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke përmbushur në vlerësimin e Kolegjit definicionin e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë në kuptim të neneve 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

22.7 Nga analizimi dhe interpretimi i dispozitave të cituara me sipër lidhur me parimin e proporcionalitetit, Kolegji arsyeton se në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, parimi i proporcionalitetit është një nga tërësia e parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit, dhe nuk mund të merret si parim *i shkëputur* për të mbuluar pasaktësitë dhe pamjaftueshmëritë e subjekteve të rivlerësimit në deklarime.

- 23.** *Lidhur me mosdeklarimin e pasurisë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, në adresën e personit tjetër të lidhur, shtetasit R. Sh.*, subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimi i Komisionit për deklarim të pasaktë, është i gabuar, pasi i ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike adresën e tij të banimit në banesën e dajës së tij, shtetasit R. Sh.

23.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në deklaratat e interesave private periodikë vjetorë 2008-2012, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar adresën e banimit në {***}, pranë Shkollës së Policisë. Shtëpia me këtë adresë është në pronësi të dajës së subjektit, z. R. Sh., e përfutur me leje legalizimi në vitin 2015. Kontrata e energjisë elektrike është në emër të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2011-2018, të cilën e ka deklaruar si adresë banimi që prej vitit 2008, në deklaratën para fillimit të detyrës.

23.2 Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë fakt, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar se adresa që ka deklaruar në deklaratimet periodike për periudhën 2008-2012, është adresa ku ka banuar dhe është e dajës së tij R. Sh. Subjekti sqaron se ka banuar në atë banesë, por nuk e ka pasur në përdorim vetjak, pasi banesa gjatë gjithë kohës është përdorur nga daja dhe familjarët e tij. Ata nuk janë larguar nga banesa asnjë ditë dhe subjekti thotë që ka banuar si pjesëtar “de facto” në këtë familje. Formulari i deklarimit periodik nuk përmban një rubrikë ku mund të pasqyrohet një lloj marrëdhënieje e kësaj natyre. Më tej subjekti sqaron se deklarimi periodik kërkon deklarimin e adresës së banimit dhe këtë detyrim ligjor pretendon se e ka përmbushur.

23.3 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar adresën e vendit ku banon në të gjitha deklaratimet e intervalit kohor (2008-2013) që ka banuar në shtëpinë e z. Sh., për pasojë kuptohet që nuk ka pasur si qëllim mosdeklarimin e këtij destinacioni. Nga dokumentacioni i administruar në dosje dhe rrethanat faktike, rezulton se kjo banesë i është ofruar nga daja i tij si mbështetje për

qëllime strehimi dhe jo në kuptim të përdorimit të sendit si e drejtë reale, pasi subjekti i rivlerësimit ka jetuar bashkë me familjen e dajës së tij. *Sa më sipër, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i bazuar.*

24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kontrata e energjisë elektrike është hapur nga autoriteti kompetent OSHEE, ku abonenti nuk ka akses në vendimmarrje, bazuar në vetëdeklarimin për legalizimin e banesës në emër të z. R. Sh. Sipas subjektit, shkaqet për hapjen e kontratës së energjisë elektrike janë shpjeguar bindshëm, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se banonte në banesën e tij në Elbasan dhe nuk kishte të bënte me banesën e z. R. Sh., nga ku ishte larguar që në vitin 2015.

24.1 Lidhur me kontratën e energjisë elektrike, e cila rezulton në emër të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit në përgjigjet e datës 14.02.2019, të pyetësorit të realizuar nga Komisioni, ka sqaruar se arsyeja pse e kishte lidhur kontratën në emrin e tij, ishte për shkak se në matësin e katit të parë të banesës së dajës së subjektit, z. R.Sh., kishte pasur mbifaturime të energjisë elektrike të vendosura padrejtësisht, ndaj me ankesat zyrtare të bëra nga z. Sh., të njëjtët faturues e rilidhnin energjinë elektrike. Pasi fakti i ndërprerjes së energjisë u bë i shpeshtë dhe nevoja e subjektit për të punuar në kompjuter ishte e përditshme, ka vendosur të lidhë kontratën e energjisë elektrike në emrin e tij, për të shmangur ndërprerjet e padrejta të energjisë elektrike. Kolegji vëren se në dosjen gjyqësore gjendet procesverbal i OSSH-së, datë 26.03.2008, për ndërprerjen e energjisë elektrike, pasi abonenti R. Sh. rezulton të jetë debitor në banesën e ndodhur në Sauk. Në një tjetër njoftim të OSSH-së nga Departamenti i Arkëtiveve, i cili mban datën 12.08.2010, rezulton si debitor z. Sh. për periudhën 2007-2010, çka provon se debia kundrejt OSSH-së ka lindur përpara se subjekti i rivlerësimit të banojë te shtëpia e dajës së tij.

24.2 Në dosje është administruar dhe “Njoftim përfundimtar”, akt i nxjerrë nga OSSH, datë 08.12.2010, nëpërmjet të cilit njoftohet debitori R. Sh.për shlyerjen e detyrimit në vlerën totale 137040 lekë. Në datën 20.10.2009, z. Sh.ka bërë një ankesë, nëpërmjet së cilës i drejtohet OSSH-së në lidhje me problemin e mbifaturimit, ankesë e cila nuk është protokolluar nga ky institucion, por fakti që detyrimi ekziston, sipas njoftimeve të OSSH-së, të krijon bindjen që është përpiluar në kohën reale të lindjes së problemit. Më shkresën nr. {***}, datë 31.10.2019, OSHEE ka njoftuar Komisionin se kontratës, e cila ka rezultuar në emër të subjektit të rivlerësimit, i është ndryshuar emri i abonentit duke e kaluar në emër të shtetasit R. Sh. Nga kartela e abonentit, rezulton se ky ndryshim është bërë më datë 02.05.2018. Gjithashtu, në praktikën e ALUIZNI-t dërguar Komisionit, ky i fundit rezulton të jetë subjekt vetëdeklarimi për leje legalizimi të banesës objekt shqyrtimi që në vitin 2005 (3 vite përpara fillimit të detyrës së subjektit), të cilit i është emetuar leja për legalizim më datë 06.05.2015. Nga sa u analizua më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti e ka deklaruar adresën e qëndrimit te z. Sh dhe shkaqet për të cilat është lidhur kontrata në emër të subjektit të rivlerësimit janë qartësuar, pasi dokumentacioni i administruar në dosje përputhet me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit. *Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i bazuar.*

25. *Lidhur me pasurinë tokë arë, me sip. 207 m², në fshatin {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, përfituar me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2011, me vlerë sipas kontratës 72450 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar që nuk bazohet në prova dhe në ligj, kur arsyet në vendim se megjithëse konsideron referencën e parashikuar në VKM-në e vitit 2008, e cila ka vijuar të jetë në fuqi deri në blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, krijon bindjen se ka dyshime të*

arsyeshme, të cilat mbeten të pamundura për t'u provuar, me gjithë hetimin e thelluar se subjekti është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e kësaj pasurie.

25.1 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2011, në vlerën prej 72.450 lekësh. Pasuria e paluajtshme ndodhet në fshatin {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, me sipërfaqe 207 m². Certifikata e pasurisë në emër të z. Fatmir Lushi, është lëshuar më datë 03.01.2012 nga ZVRPP Tiranë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, sipas deklaratës të subjektit të rivlerësimit, janë kursimet nga të ardhurat nga paga si prokuror dhe paga e bashkëjetueses si mësuese.

25.2 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, tokë arë me sipërfaqe 207 m², në fshatin F{***}, Tiranë, në vlerën prej 72.450 lekësh. Në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

25.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri me të dhënat e mësipërme, me çmimin 72.450 lekë në total, për 207 m² sipërfaqe, nga ku rezulton që çmimi për metër katror të jetë 350 lekë. Komisioni i ka dërguar shkresë³ Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, nëpërmjet së cilës kërkon informacion nëse çmimi i shitjes prej 350 lekësh për m², në datën 22.12.2011, për tokën arë, në zonën kadastrale {***} në {***}, Tiranë, është në përputhje me çmimin e referencës dhe çmimin mesatar për vitin 2011, për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme arë në këtë zonë kadastrale. ZVRPP Tiranë ka kthyer përgjigje⁴ në lidhje me çmimin e referencës që në këtë zonë kadastrale, në fshatin {***}, në vitin 2011 ka qenë në vlerën 4480 lekë për m².

25.4 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit lidhur me konstatimet e Komisionit, ka sqaruar se çmimi i referencës i dhënë në përgjigjen e shkresës nr. {***} prot., datë 11.01.2019, të ZVRPP Tiranë, është i gabuar, pasi mund të kenë shtuar një zero dhe se ky çmim reference bazohet në Vendimet e Këshillit të Ministrave, të dala pas vitit 2011. Subjekti sqaron se vetë pronari i pronës, të cilit i ka blerë tokën, z. Xh. Sh, në vitin 2015 është shpronësuar për shkak të ndërtimit të Unazës Lindore Tiranë dhe është kompensuar me çmim reference 448 lekë për m², për një sipërfaqe 64 m², në vlerë gjithsej 28.672 lekë. Pra, subjekti sqaron se shumë vite më vonë, pas ndryshimeve të ligjeve në fuqi, që nga viti 2011, vlera është rritur me një diferencë të vogël, ndaj dhe përgjigjja e ZVRPP Tiranë është e gabuar.

25.5 Subjekti i rivlerësimit në vitin 2008 ka blerë po nga shitësi Shkalla 276 m² tokë arë, në vlerën 350 lekë/m². Komisioni i ka dërguar shkresë⁵ ZVRPP-së Tiranë, nëpërmjet së cilës i kërkon informacion nëse çmimi 350 lekë/m², në vitin 2008, për tokë "arë", në zonën kadastrale {***} ({***}), është në përputhje me çmimin e referencës për këtë zonë. ZVRPP-ja Tiranë ka kthyer përgjigje⁶, në të cilën ka bërë me dije se sipas VKM-së nr. 139, datë 13.02.2008, çmimi 350 lekë është sipas çmimit të referencës, dhe ka bashkëlidhur edhe VKM-në. Pra, rezulton se përveç se në vitin 2008, subjekti ka blerë tokë bujqësore me të njëjtin çmim për metër katror edhe në vitin 2011.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.12.2018.

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.01.2019.

⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.08.2018.

⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.02.2018.

25.6 Në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 187, datë 06.03.2013, “Për miratimin e vlerës së pronës në secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, për qarkun e Tiranës, fshati {***}, zona kadastrale {***}, është përcaktuar çmimi i tokës bujqësore në vlerën 448 lekë për m². Në VKM-në nr. 89, datë 02.09.2016, sërish rezulton se për qarkun e Tiranës, fshati {***}, zona kadastrale {***}, është përcaktuar çmimi i tokës bujqësore në vlerën 448 lekë për m². Që këtej del qartë se çmimi i dhënë (4480 lekë/m²) nga shkresa e ZVRPP-së, në përgjigje të Komisionit për çmimin e referencës së vitit 2011, është një gabim material, në të cilin çmimit prej 448 lekësh për m² rezulton t’i jetë shtuar një zero. Si rrjedhojë, nga provat dhe aktet ligjore që rezultojnë në dosje, çmimi i blerjes së tokës (350 lekë/m²) nuk është disa herë më i vogël, siç ka konkluduar Komisioni, se çmimi 4480 lekë/m² sipas shkresës së ZVRPP-së Tiranë, pasi nuk ekziston një çmim i tillë i lartë as në VKM-të e viteve pasardhëse, dhe as rezulton të ketë VKM të vitit 2011 për përcaktimin e çmimit të referencës.

25.7 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të blerë këtë pasuri edhe nëse përdorim çmimin e konfirmuar nga ZVRPP Tiranë. Kolegji vëren se nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, rezulton se në DIPP-në e vitit 2011 për pasurinë e paluajtshme “tokë arë 207 m²” nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie. Meqenëse është deklarim në deklaratën periodike, vlerësohet se kjo pasaktësi, nëse qëndron e vetme e këtij lloji dhe për sa kohë që subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e pasurisë, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi.

- 26.** Lidhur me depozitën bankare me afat 1-vjeçar së bashku me bashkëjetuesen, znj. R. H, më datë 22.02.2016, në Bankën Kombëtare Tregtare, në vlerën 1500000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ligji nr. 9049/2003 për mosmbajtjen e gjendjeve mbi 1,5 milionë lekë jashtë sistemit bankar, e lidh me subjektet të cilat deklarojnë për herë të parë jo me subjektet të cilat bëjnë deklarime periodike. Edhe në këndvështrimin e nenit 4/1 të ligjit nr. 9049/2003, është përmbushur detyrimi ligjor, pasi shuma prej 1,5 milionë lekësh kursime *cash* të vitit 2015, është vendosur në bankë në datën 22.02.2016, ndërsa deklarimi i pasurisë për vitin 2015 është bërë në datën 18.03.2016, që do të thotë se depozitimi në institucionet bankare i gjendjes *cash* është bërë përpara dorëzimit të deklaratës.

26.1 Në DIPP-në e vitit 2015, në rubrikën e ndryshimit të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar: *Gjendje cash (kursime nga paga vjetore së bashku me bashkëjetuesen), ku 800.000 lekë janë kursime të deklaruara në deklarinë periodik të mëparshëm. Shuma prej 1500.000 lekësh, në momentin e deklarinë në shkurt 2016, është depozituar në bankën BKT. Ndërsa 300.000 lekë gjendje cash. Në dhjetor të vitit 2015, në llogarinë e pagës së bashkëjetueses, në BKT figurojnë të patërhequra 91412,98 lekë. Kjo shumë përfshihet në gjendjen totale cash. Në dhjetor të vitit 2015, në llogarinë e pagës së subjektit në Raiffeisen Bank, figurojnë të patërhequra 41635,21 lekë. Kjo shumë përfshihet tek totali cash.*

26.2 Kolegji vëren se shuma *cash* prej 1,5 milionë lekësh e personit të lidhur, e mbajtur në banesë, është deklaruar më 18.03.2016 në DIPP-në e vitit 2015. Në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar me ligjin nr. 45/2014, në nenin 4, pika 1, parashikon: *Subjektet e këtij ligji, që plotësojnë deklarinë për herë të parë, sipas nenit 5/1 të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në cash, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1,5*

(një presje pesë) milionë lekë. Për subjektet që deklarojnë sipas nenit 5/1 të këtij ligji, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve cash mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

26.3 Në përfundim të analizës më sipër, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit e ka krijuar depozitën prej 1.500.000 lekësh nga *cash*-i i akumuluar deri në vitin 2015, nga i cili ka krijuar depozitën në datën 22.02.2016, të cilën e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015, dorëzuar në ILDKPKI më datë 08.03.2016. Në këtë rast, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar afatet e deklarimit sipas nenit 7, pika 3 e ligjit nr. 9049/2003, pasi e ka depozituar shumën në shkurt të vitit 2016 dhe e ka deklaruar në deklaratën periodike të një viti më përpara (2015), rezultoi se faktet e konstatuara nuk mund t'i atribuohen ndonjë shkeljeje ligjore të tillë që të jetë e mundur të identifikohet si një shkak që mund të ngrihet në nivelin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ndonjë nga parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 33, pika 5 e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Analizimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

27. Lidhur me kontrollin e figurës, DSIK ka dërguar në Komision raportin nr. {***} prot., datë 07.02.2019, i deklasifikuar pjesërisht, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit, përfshihet në veprime korruptive në dy çështje të ndryshme, të cilat u referohen verifikimeve të autoriteteve përkatëse. Ky raport, ndër të tjera, ka pasqyruar:
1. Disponohen të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar një shtetas të proceduar penalisht për falsifikim dhe hedhje në treg të kartëmonedhave të jashtëligjshme, kundrejt një shume të caktuar parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan.
 2. Disponohen të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar një shtetas të proceduar penalisht, kundrejt një shume të caktuar parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Për sa më sipër, në vlerësimin e të dhënave për subjektin e rivlerësimit, Grupi i Punës ka konstatuar papërshtatshmërinë për ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.
28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i është dhënë mundësia për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Sipas tij, Komisioni ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve ndaj subjektit, me vlerësime të natyrës përgjithësuese për kriterin e figurës, duke krijuar bindjen e brendshme, pa treguar të dhënat se ku e bazon këtë bindje. Duke mos e njohur subjektin e rivlerësimit me provën apo të dhënë që provon veprimtarinë korruptive të kryer prej tij, nuk i garantohet e drejta për t'u mbrojtur dhe për të provuar të kundërtën. Subjekti pretendon gjithashtu se nuk i është bërë e ditur asnjë e dhënë apo informacion i disponuar nga Komisioni apo përmbajtje e së dhënës konfidenciale të deklasifikuar që lidhet me punën dhe figurën e tij si prokuror apo për përfshirjen në veprime korruptive.

28.1 Kolegji vëren se më datë 04.03.2019, Komisioni me vendimin nr. 2 ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, bazuar në relacionin “Mbi rezultatet e hetimit administrativ”, të paraqitur nga relatorja e çështjes. Më datë 07.03.2019, Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit. Në këtë njoftim, Komisioni e fton subjektin e

rivlerësimit të njihet me dosjen dhe të marrë kopje të saj, si dhe të depozitojë prapësimet brenda datës 18.03.2019. Ndërmjet dokumenteve të administruara në dosjen e Komisionit, gjendet një deklaratë e firmosur nga subjekti i rivlerësimit më datë 08.03.2019, pra të nesërmen e njoftimit të rezultateve të hetimit. Në këtë deklaratë citohet se subjekti u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij me CD, që nuk ka vërejtje në lidhje me materialet e tërhequra, si dhe dokumentacioni është konform inventarit që shoqëron dosjen dhe i është vënë në dispozicion.

28.2 Bashkëlidhur kësaj deklarate, gjendet inventari i dokumenteve që ka marrë për t'u njohur subjekti i rivlerësimit. Në përmbajtje të këtij inventari, figurojnë të jenë 3 dosje, në përbërje të së cilave rezultojnë raportet e DSIK-së, përkatësisht raporti i datës 18.12.2018, i deklasifikuar pjesërisht, si dhe raporti i datës 19.02.2019, edhe ky i deklasifikuar pjesërisht. Siç del nga rrjedha e veprimeve të renditura më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit i dispononte raportet e DSIK-së, si dhe procedimet penale sipas dosjeve të prokurorive respektivisht të Elbasanit dhe Shkodrës. Pra, subjekti i rivlerësimit rezulton i njohur me këto dokumente, të cilat i ka tërhequr pranë Komisionit dhe për të cilat kishte kohën në dispozicion për t'u njohur me to, si dhe për të dorëzuar prapësimet në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht të Komisionit. *Sa më sipër, shkak u ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk është i bazuar.*

29. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni gjendet në zbatim të gabuar të ligjit, çka e justifikon duke cituar vendimin e GjEDNj-së *Regner kundër Republikës Çeke*, ku në përmbajtje të këtij vendimi përcaktohet shprehimisht se: *në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuarit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'i përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...].* Komisioni nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor për të njohur subjektin e rivlerësimit me të dhënat që rezultojnë nga pjesët e deklasifikuara, me qëllim që t'i mundësohet subjektit të rivlerësimit provueshmëria e së kundërtës.

29.1 Kolegji vëren se lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shkeljen e së drejtës për t'u njohur me të dhënat që rezultojnë nga pjesët e deklasifikuara pjesërisht, vërehet se subjekti është njohur me materialin e deklasifikuar, përveç emrave të cilët janë të anonimizuar, por në tërësinë e dokumentit të klasifikuar jepen detajet për çështjet të cilat i kishte hetuar vetë subjekti i rivlerësimit dhe për të cilat kishte dijeni. Në rastin *Regner kundër Republikës Çeke*, kërkuarisi nuk ishte vënë fare në dijeni të dokumentit të klasifikuar, ndryshe nga subjekti i rivlerësimit i cili e ka marrë informacionin e klasifikuar. Nga ky vendim citohet: *Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave nga kërkuarisi, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjyqimit bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, ishin balancuar në një mënyrë të tillë që një balancë e drejtë ndërmjet palëve nuk ishte cenuar në mënyrë të tillë që të cenonte thelbin e së drejtës së kërkuarit për një gjykim të drejtë. [...] e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim [...].* Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuarit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'u përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të

ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...]. Në përfundim të këtij vendimi, edhe pse dokumentacioni i klasifikuar nuk i ishte dhënë kërkuesit për t'u njohur me të, nga gjykata (GjEDNj) konkludohet se nuk ka shkelje.

29.2 Në rastin e subjektit të rivlerësimit, përveçse i është bërë e mundur njohja me dokumentacionin e klasifikuar pjesërisht, i është dhënë mundësia të shprehet dhe të propozojë lidhur me këtë dokumentacion, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Si rrjedhojë, konstatohet që procedura e vendimmarrjes është në pajtueshmëri me kërkesat e gjykimit bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke mundësuar garancitë e duhura për mbrojtjen e interesave të subjektit të rivlerësimit. *Sa më sipër, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.*

- 30.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se veprimet e kryera prej tij në kuadër të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016 të Prokurorisë Elbasan, në përfundim të tyre së bashku me vendimmarrjen për pushimin e çështjes, ligjshmërinë e përgjimeve të realizuara për nevoja të këtij procedimi, si dhe asgjësimi i përgjimeve, janë kontrolluar dhe gjetur të drejta nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky fakt provohet sipas subjektit me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2017, të kësaj gjykate. Po të ishte e kundërta, gjykata do të urdhëronte kryerjen e veprimeve hetimore shtesë apo nuk do të pranonte asgjësimin e materialeve të përgjimit.

30.1 Kolegji vlerëson se lidhur me këtë shkak ankimi nuk mund të mbajë një qëndrim, pasi përgjimet janë asgjësuar me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj nëse është kontrolluar nga kjo gjykatë ligjshmëria e përgjimeve të realizuara për nevoja të procedimit penal nr. {***}, është e pamundur të saktësohet për sa kohë nuk i kemi provat për të konstatuar faktin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

- 31.** Subjekti pretendon se të gjitha konstatimet që ka evidentuar nga pikat⁷ 1.5 deri në 1.8 të vendimit përfundimtar të Komisionit, në lidhje me veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit

⁷*Pikat e vendimit të Komisionit të cilave u referohet subjekti i rivlerësimit:*

- Komisionit i rezultoi se në dosje nuk ishin administruar akte mbi zbatimin e autorizimeve "Për përgjimin", sikurse subjekti kishte kërkuar të dorëzoheshin raporte përmbledhëse.

- Komisioni ka konstatuar se nga subjekti nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim, që i mundëson procedura penale, nëpërmjet letër porosisë, sipas parashikimit të nenit 332/ç të Kodit Penal, për të siguruar kartëmonedhën false me cilësinë e provës.

- Gjatë veprimeve hetimore mbi vënien në përgjim të numrave të telefonit për shtetasit e akuzuar, Komisioni konstatoi se subjekti kishte kërkuar përgjimin e një numri telefoni të ndryshëm nga ai që identifikohet se përdorej nga i akuzuari dhe, për pasojë, edhe gjykata është shprehur gabim.

- Nuk kishte arsyetuar se kur dhe si kishte rënë në dijeni të faktit se ky numër ishte i të akuzuarit [...].

- Komisioni vërejt: megjithëse nga ana e subjektit argumentohet se nga transkriptimi i bisedave telefonike "[...] krijohen dyshime për kryerje veprimesh të paligjshme, dhe se rezultonte e nevojshme që të zgjatej afati i përgjimit, në vendimin e pushimit, subjekti ka arsyetuar se nga përgjimet nuk mësohej ndonjë e dhënë me interes për hetimin".

- Rezulton se në dosje nuk janë administruar aktet që provonin përgjimin, si dhe subjekti me kërkesën e tij ka kërkuar asgjësimin e tyre.

- Mbi hetimin e kësaj dosjeje nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se, edhe pse Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan, "pas kërkesës së subjektit për këqyrje banese", kishte informuar se veprime të tilla "[...] do të pengonin hetimin e strukturave të tjera", nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim që mund të konfirmonte vërtetësinë e përmbajtjes së përgjigjes së Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan.

- Nuk ishte kryer asnjë veprim procedural për të verifikuar nëse prokuroritë e tjera kishin të regjistruar ose jo si persona nën hetim shtetasit e akuzuar për të njëjtën vepër penale që po i hetonte Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, apo për vepra penale të tjera. Mbi këtë konstatim të Komisionit, është shprehur edhe Prokuroria e Përgjithshme në opinionin e saj pas kërkesës së Komisionit.

penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, që sipas ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë, shoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues të dosjes penale, si dhe në “Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ”, provojnë se konstatimet e Komisionit janë të gabuara, të pabazuara në prova dhe në dokumentacionin ligjor të dosjes penale.

31.1 Komisioni, lidhur me këtë procedim penal, ka arsyetuar se hetimi nuk është i plotë, si dhe nuk janë mbledhur të gjitha provat e kërkuara për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv.

31.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, Kolegji vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e materialit referues të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, më datë 03.06.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprat “Korrupsion pasiv në sektorin privat” dhe “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar përkatësisht nga nenet 164, germa “b” dhe 183, pika 2 e Kodit Penal. Krahas regjistrimit të procedimit penal, është urdhëruar gjithashtu edhe shënimi në regjistër i emrave të shtetasve D. H dhe D. Ç, në cilësinë e personave nën hetim. Nga përmbajtja e aktit “Informacion mbi referimin e veprës penale”, të përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore vërehet: *Në lidhje me shtetasin D. H, punonjës në Alfa Bank, dega Elbasan, dhe disa shtetas të tjerë bashkëpunëtorë të tij, nga ana jonë, në rrugë operative legale, janë siguruar të dhëna se po hedhin në qarkullim monedha të falsifikuara, të vjedhura në banka të vendeve të Bashkimit Evropian [...]. Disponohen të dhëna të mëparshme në rrugë operative legale se shtetasi D. Ç po kryen veprimtari kriminale në drejtim të falsifikimit të kartëmonedhave dhe çngjyrosjes së kartëmonedhave të vjedhura në banka të BE-së. Këtë aktivitet e kryen në bashkëpunim me vëllain e tij I. Ç [...]*”.

31.3 Në vijim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, më datë 08.06.2016, ka lëshuar autorizim për përgjim në vende publike të shtetasve D. H dhe D. Ç, përgjim i cili do të kryhej me fotografime, filmime dhe video në një periudhë të caktuar nga 09.06.2016 deri më 26.06.2016. Për realizimin e këtij përgjimi janë ngarkuar oficerë të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Posaçme Operacionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pas autorizimit të përgjimit të lëshuar nga prokurori, nga oficerët e policisë gjyqësore nuk është kryer asnjë veprim në lidhje me përgjimet dhe as është dërguar në prokurori asnjë informacion në lidhje me arsyet e mosrealizimit. Subjekti i rivlerësimit, më datë 20.07.2016, ka lëshuar sërish autorizim për përgjim në vende publike për të njëjtët persona. Edhe në këtë rast, oficerët e policisë gjyqësore nuk kanë kthyer asnjë informacion në lidhje me përgjimet dhe as arsyet e mosrealizimit të këtij përgjimi sipas autorizimit të subjektit të rivlerësimit.

31.4 Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan i ka dërguar shkresë⁸ Drejtorisë Vendore të Policisë së Elbasanit për të informuar prokurorinë në lidhje me përgjimet e autorizuara nga prokurori Fatmir Lushi, në funksion të hetimit dhe shkaqet e mosrealizimit. Po kështu, i ka dërguar shkresë⁹ edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të kërkuar informacion lidhur me përgjimet e autorizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe arsyet përse nuk kanë sjellë

- Komisioni, në analizim të kësaj dosjeje, ka konstatuar se, edhe pse nga deklaratimet e shtetasve që kishin dijeni për veprën penale, ishin marrë deklaratime mbi aktivitete private, ushtrime biznesi, si dhe përdorim automjeti, subjekti nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor mbi vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre, në një kohë që çështja i referohej kryerjes së veprave penale të “Korrupsionit pasiv në sektorin privat” dhe “Falsifikimit të monedhave”.

⁸ Shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2016.

⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2016.

informacion. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka kthyer përgjigje me shkresën {***} prot., datë 09.09.2019 (viti duket se është gabim shtypi) ku ndër të tjera citon se në lidhje me autorizimet e prokurorit Fatmir Lushi nuk janë kryer vëzhgime të fshehta në ambiente publike, për shkak të ngarkesës dhe numrit të madh të procedimeve që ka pasur në ndjekje ky sektor. Ndërsa Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 27.11.2016, ku ndër të tjera citon se pas sigurimit të të dhënave nga burime operativo-legale, nuk janë kryer veprime të tjera hetimore. Arsyeja është se për personat e dyshuar për të cilët është referuar materiali, po kryhen veprime procedurale nga prokuroritë e rretheve të tjera dhe me qëllim të mosdëmtimit të hetimeve të strukturave të tjera, nuk mund të jepen detaje.

31.5 Kolegji vëren se nga dokumentacioni që ndodhet në dosjen penale që i përket procedimit penal nr. {***}, nuk rezulton të jenë kryer verifikime nga subjekti i rivlerësimit se cila prokurori i kishte në hetim këta persona, dhe a hetoheshin për të njëjtën vepër penale që po i hetonte Prokuroria e Elbasanit apo për vepra penale të tjera. Nëse do të rezultonte i vërtetë informacioni që po kryhen hetime për këta shtetas edhe nga prokuroritë e tjera, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për zbatimin e nenit 306 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim “KPrP”), sipas të cilit parashikohen rastet e marrëdhënieve mes prokurorive për bashkërendimin e punëve në procedimet e lidhura.

31.6 Kompanitë celulare, të cilave subjekti i rivlerësimit u ka kërkuar informacion me qëllim kërkimin në gjykatë për lejimin e përgjimit të bisedave telefonike, i kanë dërguar Prokurorisë së Elbasanit numrat e telefonisë celulare bashkë me gjeneralitetet dhe numrin e identifikimit për dy nga të dyshuarit vëllezërit Ç.. Me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 25.11.2016, lejon përgjimin e këtyre numrave, mbajtësit e të cilëve ishin tre personat e dyshuar. Si rezultat i këtyre të dhënave, nuk janë të qarta rrethanat se si është vënë në dijeni subjekti i rivlerësimit për numrat celularë për të cilët ka kërkuar lejimin e përgjimit, përveç faktit që ishin referuar tek informacioni i oficerës së policisë gjyqësore, numra të cilët nuk korrespondojnë me numrat e dërguar nga kompanitë celulare që u përkisnin emrave të të dyshuarve dhe, për më tepër, një ndër mbajtësit e këtyre numrave ishte babai i dy të dyshuarve Ç., i cili në numrin e tij të përgjuar nuk kishte telefonata hyrëse dhe dalëse.

31.7 Lidhur me asgjësimin e materialeve të përgjimit, Komisioni ka konkluduar: *megjithëse nga ana e subjektit argumentohet se nga transkriptimi i bisedave telefonike [...] krijohen dyshime për kryerje veprimesh të paligjshme, dhe se rezultonte e nevojshme që të zgjatej afati i përgjimit, në vendimin e pushimit, subjekti ka arsyetuar se, nga përgjimet, nuk mësohej ndonjë e dhënë me interes për hetimin. Rezulton se në dosje nuk janë administruar aktet që provonin përgjimin, si dhe subjekti me kërkesën e tij ka kërkuar asgjësimin e tyre. Ndër arsyet për të cilat subjekti ka kërkuar lejimin e përgjimit nga gjykata, ka renditur: [...] personat e dyshuar bashkëpunojnë me persona të tjerë në Durrës dhe, në këto kushte, është e domosdoshme që të vihen në përgjim numrat e telefonit celular të personave të lartpërmendur, pasi dyshohet për përfshirje në veprimtari kriminale dhe nga komunikimet telefonike të këtyre numrave mësohen të dhëna me interes për hetimin. Ky dyshim i arsyeshëm bazohet në tërësinë e akteve që përbëjnë fashikullin e procedimit penal {***}.*

31.8 Subjekti i rivlerësimit, më datë 02.03.2017, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, bazuar në nenin 224¹⁰, pika 1 e KPrP, fshirjen dhe asgjësimin e materialeve të përgjimit telefonik të shtetasve të dyshuar, gjithsej 4 CD dhe 29 fletë transkriptim, pasi ky dokumentacion nuk është i nevojshëm. Në vijim, kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2017, ka vendosur si të drejtë kërkesën e prokurorit, duke lejuar asgjësimin e materialeve të përgjimit telefonik që u përkisnin tre të dyshuarve: D. Ç., I. Ç. dhe D. H.. Lidhur me asgjësimin e përgjimit të personave të dyshuar në këtë procedim penal, subjekti në seancën dëgjimore në Komision, ka shpjeguar se: *Dosja e përgjimit është dosje tjetër, nuk është pjesë e prokurorisë. Gjykata ka asgjësuar materialet e prokurorisë, jo të gjykatës. Pra, ne i kemi dërguar gjykatës kërkesën dhe ajo me aq sa dyshim krijonin me këto copëzime komunikimesh, na ka lejuar që të vazhdojmë përgjimin. Në përfundim, nuk ishim në të njëjtën situatë në momentin kur kemi kërkuar zgjatjen e përgjimit. Në përfundim të hetimit, e gjithë dosja është kontrolluar nga gjykata dhe jo më kot ligji ia ka lënë asgjësimin gjykatës dhe jo prokurorit, në mënyrë që prokurori të mos abuzojë me pushtetin e tij që ka për t'i realizuar, për t'i kërkuar, për t'i lejuar, për t'i përdorur dhe për t'i asgjësuar pastaj.*

31.9 Nga sa u analizua më sipër, Kolegji vëren se në dosjen gjyqësore nuk gjenden materiale të përgjimit, për shkak të asgjësimit të lejuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të vlerësuar nëse në këto përgjime kishte elemente që hidhnin dritë mbi kryerjen e veprës penale nga personat e dyshuar për të cilët është kërkuar përgjimi. Ky moment procedural është në kompetencën e gjykatës për të vendosur nëse ky dokumentacion nuk është i nevojshëm, dhe për të mund të lejohet asgjësimi, ndaj jo pa qëllim për këtë kërkesë të prokurorit vendos gjykata që ka bërë vleftësimin e përgjimit, në mënyrë që të vlerësohen arsyet për të cilat është diktuar nevoja për përgjim me atë çfarë ka rezultuar nga lejimi i tij.

31.10 Kolegji nuk e gjen të bazuar në ligj e në prova konkluzionin e Komisionit në paragrafin 1.8 të arsytimit të vendimit të tij, pasi, nga sa rezulton sipas dokumentacionit të administruar në këtë çështje, nuk krijohet bindja se me veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në trajtimin e çështjes së sipërcituar ka ardhur pasoja e favorizimit të shtetasve nën hetim.

32. Subjekti përsëri nëpërmjet ankimit pretendon se qëndrimi i Komisionit është i gabuar kur arsyeton se subjekti nuk ka regjistruar në kuadër të procedimit penal nr. {***} edhe veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal, pasi OPGj-ja në referimin e saj shprehet se mendohet që ka elemente të veprës penale të mësipërme. Subjekti referon se jo detyrimisht sa referon policia gjyqësore mbi veprat penale që mendon se janë konsumuar, duhet të regjistrohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Nëse nuk ka të dhëna apo indicie të lidhura për konsumimin e veprës penale, nuk mund të regjistrohet vepra penale.

32.1 Lidhur me shkakun e mësipërm, Kolegji vëren se më datë 02.06.2016, OPGj-ja e çështjes i ka referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan se, më datë 01.06.2016, ka marrë dijeni për veprat penale, duke i referuar elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, si dhe duke vënë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të

¹⁰Neni 224, pika 1 e KPrP parashikon: “Procesverbalet dhe regjistrimet ruhen pranë prokurorisë që ka urdhëruar përgjimin derisa vendimi të marrë formë të prerë, me përjashtim të atyre që ndalohet përdorimi. Por, kur ky dokumentacion nuk është i nevojshëm, të interesuarit mund të kërkojnë asgjësimin e tij. Mbi këtë kërkesë vendos gjykata që ka bërë vleftësimin e përgjimit. Asgjësimi bëhet nën kontrollin e gjyqtarit dhe për veprimin mbahet procesverbal”.

gjitha aktet dhe provat e marra. Ndër të tjera, oficerja pasi ka dhënë të gjitha informacionet që mund t'i shërbejnë prokurorisë lidhur me personat e dyshuar, si dhe me veprimet e tyre, në përfundim të informacionit ka konkluduar: *Në përfundim të sa më sipër, mendojmë që konstatohen elemente të veprës penale "Falsifikim i monedhave", "Pastrim i produkteve të veprës penale" dhe "Korrupsion pasiv në sektorin privat", parashikuar përkatësisht nga nenet 183, 287, 164/b të Kodit Penal, me të dyshuar D. H. dhe D. Ç..* Pra, oficerja e policisë gjyqësore, bazuar në nenin 293¹¹ të KPrP parashtron të gjitha informacionet që disponon për veprën penale, duke ia vënë në dispozicion prokurorisë për vlerësim.

32.2 Më tej, prokurori, bazuar në nenin 287¹², pika 1 e KPrP, shënon në regjistër njoftimin e veprave penale, si dhe personat të cilëve u atribuohet vepra. Siç del nga këto nene të sipërpërmendura, oficeri i policisë gjyqësore kryen veprime hetimore që i janë urdhëruar apo deleguar nga prokurori, ndaj referimet dhe informacionet nuk mund të jenë detyruese për punën e prokurorit. Oficerët e policisë gjyqësore janë në varësi funksionale të prokurorit dhe, nga ana tjetër, është ky i fundit që vlerëson për veprimet hetimore që do të ndërmerren. Si rrjedhojë, pavarësisht nga referimi i OPGj-së në informacionin e dërguar prokurorit, nuk mund të merret e mirëqenë për t'u regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, pasi është diskrecion i prokurorit ngritja e akuzës në varësi të vlerësimeve të tij në lidhje me rrethanat dhe elementet e veprës penale dhe, për pasojë, edhe regjistrimi i njoftimit të veprave penale sipas kërkesave të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale. *Sa më sipër, shkaku i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i bazuar.*

33. Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti pretendon se të gjitha konstatimet e Komisionit që ka evidentuar në pikat¹³ 2.1

¹¹ Neni 293, pika 1 e KPrP parashikon: *"Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit"*.

¹² Neni 287, pika 1 e KPrP parashikon: *"Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale"*.

¹³ Pikat e vendimit të Komisionit të cilave u referohet subjekti i rivlerësimit:

- Ky procedim penal rezulton se ishte regjistruar për veprat penale të "Plagosjes së rëndë me dashje" dhe "Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta".

- Nga rrethanat e çështjes, referohej një ngjarje në vitin 2010, e ndodhur në një drekë të organizuar nga kryetari i Këshillit të Komunës H., z. L. B., ku ndër të tjerë kishte marrë pjesë edhe i pandehuri Gj. L. Pas përfundimit dhe largimit nga ky organizim, i pandehuri Gj. L., në një sherr me shtetasin Z. Gj., ka nxjerrë një thikë dhe e ka goditur[...]. I pyetur me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, shtetasi Gj. L. ka mohuar faktin që i atribuohet.

- Nga aktet e administruara në dosje, Komisioni, konstatoi se nga subjekti nuk ishin kryer veprime hetimore lidhur me veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta", si dhe dukej se subjekti, edhe pse në konkluzionet përfundimtare kishte renditur rrethanat që rëndojnë pozitën e të pandehurit, të tilla si:

i. i pandehuri ka mohuar faktin që i atribuohet [...]; ii. subjekti e ka cilësuar veprën penale të rrezikshmërisë shoqërore të lartë; si dhe iii. është shprehur se në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për këtë të pandehur duhet të mbahet parasysh, rrezikshmëria e autorit të veprës penale, e cila paraqitet relativisht e lartë; iv. nga ana tjetër, ka kërkuar aplikimin e "Rrethanave lehtësuese".

- Mbi konstatimet e Komisionit në këtë çështje, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, subjekti deklaroi se: i) kishte deleguar veprimet hetimore të mundshme për t'u realizuar; dhe se ii) mundësitë për të gjetur mjetin ishin shumë të pakta. Subjekti në konkluzionet përfundimtare ishte shprehur se "[...] gjykata duhet të

deri në 2.5 të vendimit përfundimtar, në lidhje me veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi penal, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, që sipas ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë, shoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues të dosjes penale, si dhe në “Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ”, provojnë se konstatimet e Komisionit janë të gabuara, të pabazuara në prova dhe dokumentacion ligjor të dosjes penale.

33.1 Në përfundim të shqyrtimit të fakteve dhe dokumentacionit që lidhen me këtë procedim penal, Komisioni ka konkluduar: *Konstatimet mbi dosjen penale të dyshuar për veprime korruptive, siç rezulton nga qëndrimi i subjektit në përfaqësimin e akuzës, lidhur me dënimin e të pandehurit, mbështesin konstatimet e DSIK-së në raportin e tij, mbi favorizim kundrejt shumave të caktuara parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e tij si prokuror.*

33.2 Në funksion të analizimit të këtij shkak ankimi, Kolegji konstaton se, me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 27.11.2010, prokurori F. L., në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2010, për veprat penale të “Plagosjes së rëndë me dashje” dhe të “Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta”, të parashikuara nga nenet 88 e 279 të Kodit Penal, në ngarkim të autorit të dyshuar të veprës penale, Gj. L.. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: (i) Të deklarojë fajtor të pandehurin Gj. J. L. për veprën penale të “Plagosjes së rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. (ii) Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri me 2 vjet burgim.

33.3 Në aktin “diskutime përfundimtare”, që subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga Komisioni është konstatuar se: (i) i pandehuri ka mohuar faktin që i atribuohet [...]; (ii) subjekti e ka cilësuar veprën penale të rrezikshmërisë shoqërore të lartë; si dhe (iii) është shprehur se në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për këtë të pandehur duhet të mbahet parasysh, rrezikshmëria e autorit të veprës penale, e cila paraqitet relativisht e lartë; (iv) nga ana tjetër, ka kërkuar aplikimin¹⁴ e “rrethanave lehtësuese”.

mbajë parasysh qëndrimin e të pandehurit përpara, gjatë, dhe pas [...], [...] të mbahej parasysh edhe fakti që ky person ka qenë i padënuar më parë, [...] të mbahej në vëmendje se ky person paraqet rrezikshmëri të lartë”. Neni 48 është i lidhur ngushtësisht edhe me nenin 49 të Kodit Penal.

- Trupi gjyqësor, në analizë të veprimeve hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në fashikullin penal, si dhe pas qëndrimit të tij, konstaton se:

i. Subjekti nuk ka ndërmarrë veprime hetimore lidhur me veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta”, sikurse nuk rezulton të jetë administruar ndonjë akt i tillë në fashikullin penal.

ii. Pretendimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti bazohen kryesisht në hamendësime dhe jo në veprime konkrete hetimore, duke bërë kështu përpjekje për të zhvendosur mungesën e kryerjes së tyre, me faktin se ato janë pasqyruar në relacionin përfundimtar të OPGj-së.

iii. Në analizim të diskutimeve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit konstatohet se qëndrimi i tij, ku nga njëra anë rendit rrethana që rëndojnë pozitivisht e të pandehurit, nga ana tjetër i sjell në vëmendje gjykatës zbatimin e nenit 48 të Kodit Penal mbi aplikimin e rrethanave lehtësuese, bie ndesh me rolin dhe funksionin e tij si përfaqësues i organit të akuzës.

iv. Pretendimi i subjektit se, neni 48 i Kodit Penal është i lidhur ngushtësisht me nenin 49 të këtij kodi, e çon subjektin në aplikimin e kushteve të lehtësimit të dënimit për të akuzuarin, pasi sikurse është lehtësisht e verifikueshme, neni 49 i Kodit Penal është atribut i vetëm i organit gjyqësor.

¹⁴ Neni 48 I Kodit Penal: Rrethanat lehtësuese; Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijojnë: a) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore; b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër; c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit; ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim

33.4 Kolegji vëren në aktet e administruara në dosje se subjekti i rivlerësimit në përfundim të diskutimit përfundimtar është shprehur: *Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata duhet të mbajë parasysh edhe parashikimet ligjore të neneve 47, 48, 49 dhe 50 të Kodit Penal, si: rrezikshmëria e lartë shoqërore e autorit të veprës penale, e cila ka qenë relativisht e lartë, duke u nisur nga qëndrimi para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, rrezikshmëria e veprës penale është e lartë, kjo nisur nga fakti se vepra penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal, përbën krim që dënohet në maksimum deri në 10 vjet burgim; fakti që i pandehuri nuk ka qenë i dënuar penalisht më parë; mosha e re e të pandehurit, motivet që e kanë çuar në kryerjen e veprës penale. Kolegji vlerëson se në prima facie ky paragraf duket sikur ka mospërputhje në renditjen e rrethanave të cilat gjykata duhet të mbajë parasysh në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, ku nga njëra anë citohet se rrezikshmëria është e lartë dhe nga ana tjetër sjell në vëmendje faktin që i pandehuri është i padënuar më parë dhe mosha e tij e re. Kolegji vlerëson se në diskutimet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka cituar rrethana lehtësuese, ashtu sikundër ka cituar edhe nenin 50 të Kodit Penal, i cili parashikon rrethanat rënduese që duhen mbajtur parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit, ndaj ky veprim nuk vlerësohet nga Kolegji si favorizues nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit në çështjen në fjalë.*

33.5 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se në relacionin e datës 01.02.2011, për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2010, të oficerit të policisë gjyqësore, në renditjen e veprimeve hetimore, ndër të tjera, është relatuar se janë bërë kërkime për gjetjen e armës (mjetit prerës shpues), me të cilin është realizuar vepra penale, por nuk është bërë e mundur gjetja dhe fiksimi i këtij mjeti në cilësinë e provës materiale për t’u vënë në dispozicion në lidhje me këtë procedim penal. Gjithashtu, në urdhrin e datës 01.12.2016, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me procedimin penal nr. {***}, ku vërehet se në pikën 5 të urdhrin citohet: *Të kryhen veprime me qëllim gjetjen e thikës me të cilën është qëlluar i dëmtuari.*

33.6 Kolegji vëren se nga dokumentet që ndodhen në dosje, rezulton se janë kryer disa veprime hetimore që ditën e ngjarjes, më 26.11.2010, të cilat janë dokumentuar me aktet që vijnë: procesverbal i kontrollit të vendeve, datë 26.11.2010, ku është kontrolluar banesa e të dyshuarit dhe nuk është gjetur asgjë me interes për ngjarjen; procesverbal për marrjen dhe këqyrjen e provës materiale, datë 26.11.2016, ku janë sekuestruar dy telefona në pronësi të të dyshuarit; procesverbal për sekuestrimin e sendeve, datë 26.11.2010, ku janë sekuestruar dy telefonat; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, datë 26.11.2010, ku është pyetur L. B., kryetari i Komunës {***}, i cili ishte prezent në ngjarje dhe ka treguar edhe disa detaje të thikës. Po kështu, janë dokumentuar edhe procesverbale të tjera në datën 27.11.2010, për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku është pyetur i dëmtuari Z. Gj., si dhe disa kushërinj të tij, me të cilët ky i fundit ka komunikuar në telefon pas plagosjes. Pra, siç rezulton nga dokumentacioni i administruar në dosje, janë kryer

të thellë; d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale; e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar. Rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer në rrethanat e parashikuara në shkronjën “j” të nenit 50 të këtij kodi. Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.

disa veprime hetimore që në ditën që ka ndodhur ngjarja, ende pa e marrë çështjen subjekti i rivlerësimit, dhe nuk është gjetur asgjë në lidhje me mjetin e kryerjes së veprës penale. *Lidhur më këtë shkak ankimi, pretendimet e subjektit janë të bazuara.*

33.7 Në procesin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit, është e nevojshme të mbahet në konsideratë fakti që subjektet vlerësohen sa u takon kualifikimeve të tyre dhe aftësive për t'i vënë në jetë këto kualifikime në ushtrimin e funksionit të tyre dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji dhe, për rrjedhojë, në rastin e një prokurori, në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e tij për të hetuar, cilësitë e pranueshme në punë, respektimin e të drejtave të palëve ose viktimave, eficiencën dhe efektivitetin në masën e pranueshme. Për rrjedhojë, organet e rivlerësimit çmojnë aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

- 34.** Subjekti pretendon se, bazuar në nenin Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe dorëzojnë një deklaratë të detajuar për figurën, që i përket periudhës 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, ndërkohë që Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se procedimi penal nr. {***} është përpara datës 1 janar 2012. Subjekti i rivlerësimit kundërshton faktin që vendimi i Komisionit për kriterin e figurës është marrë në zbatim të gabuar të parashikimit ligjor të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi tërësor i këtij kriteri, bazuar në të gjitha dokumentet shoqëruese/justifikuese dhe në prova, subjekti pretendon se nuk rezultojnë të dhëna për cenim të besimit të publikut.

34.1 Kolegji vëren se, nëse procedimet penale merren në shqyrtim në kuadër të kontrollit të figurës, në referim të dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore në zbatim të të cilave zhvillohet procesi i rivlerësimit, konkretisht nenit Ç, pika 1 dhe nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se kriteri kohor i përcaktuar në mënyrë të shprehur në pikën 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, i referohet vetëm detyrimit për plotësimin e deklaratës së detajuar për figurën dhe deklarimin në këtë kuadër, me saktësi dhe në përputhje me rubrikat përkatëse të saj, çdo informacion, të dhënë apo rrethanë të ndodhur apo kërkuar brenda këtij afati kohor. Vetë përcaktimi i këtij afati me pikënisje datën 1 janar 2012 dhe pikë fundore datën e deklarimit sipas ligjit, konfirmon më së miri se, në lidhje me këtë periudhë kohore, do të vlerësohet saktësia dhe vërtetësia e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme. Duke qenë se referuar pikës 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, kjo deklaratë ka vlerën e provës në këtë proces dhe se deklarimi i pasaktë sjell pasoja për subjektet e rivlerësimit, legjislatori ka përcaktuar për këtë qëllim një afat të arsyeshëm e të përshtatshëm kohor për subjektet e rivlerësimit për të përmbushur një detyrim, i cili lidhet në mënyrë të pashmangshme me kujtesën.

34.2 Periudha e rivlerësimit, në këndvështrimin e kriterit profesional, për procedimin penal që i përket vitit 2010, duke marrë në konsideratë parashikimet e neneve 3, pika 12 dhe 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit dhe, referuar momentit të hyrjes në fuqi të ligjit, kjo periudhë shtrihet në intervalin tetor 2013 - tetor 2016. Kjo periudhë, referuar nenit 41, pika 4, mund të shtrihet maksimalisht, që nga 1 janari 2006 dhe në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë

profesionale, në rast se ky informacion çmohet i domosdoshëm nga ana e relatorit të çështjes apo vëzhguesit ndërkombëtar.

34.3 Kolegji vlerëson se pavarësisht se u është dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura nga subjekti në ankim, këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, por duke analizuar aftësitë profesionale të subjektit, pasi në raportin e DSIK-së rezulton se disponohen të dhëna, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këtë kontekst, është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale.

34.4 Kolegji, në mbështetje të rrethanave faktike të konstatuara në kontrollin e figurës, nisur dhe nga praktikatat e vendimmarrjeve¹⁵ të mëparshme, vlerëson se në të dyja rastet e procedimeve penale, dyshimi për akte korruptive, i shprehur nga DSIK-ja në raportin për subjektin e rivlerësimit, lidhet me persona që nuk përfshihen në krimin e organizuar sipas përcaktimeve të pikave 6, 8 e 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerëson se standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të këtij neni, por Komisioni, në vendim, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit dhe nuk arsyeton mbi asnjë nga parashikimet e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji arrin në përfundimin se rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë standardet e kontrollit që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është plotësuar nga subjekti në mënyrë të plotë dhe të besueshme, të parashikuara nga neni 38, pikat 6 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016.

34.5 Kolegji konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së dhe të pasqyruara në vendim referojnë në dyshime për veprime me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në dy çështje penale. Grupi i punës së DSIK-së nuk rezulton të ketë referuar të dhëna konkrete për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të Kreut V të ligjit nr. 84/016 që rregullon kontrollin e figurës. Raporti i DSIK-së nuk përmban informacion se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që formulari i kontrollit nuk është i plotë dhe i besueshëm sipas përcaktimeve të neneve 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, Kolegji vëren se rastet e referuara në raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për korrupsion, në mungesë të provave apo hetimit nga ana e Komisionit, në funksion të përcaktimit të ekzistencës së

¹⁵ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 1/2020, datë 15.01.2020, paragrafët nr. 66, 68 dhe nr. 6/2020, datë 18.06.2020, paragrafi nr. 43.6.

kontakteve të papërshtatshme në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës.

34.6 Nga analiza më sipër, Kolegji konkludon se në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo se ka rrethana të tilla që të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për kriterin e kontrollit të figurës. Përfundimet e Komisionit në vlerësimin e këtij kriteri janë të paplota dhe nuk janë të mirargumentuara dhe në përputhje me standardet e kontrollit të figurës dhe, për pasojë, gjenden të mbështetura në ligj dhe në prova. Komisioni nuk ka arritur të provojë me dokumente dhe argumente bindëse se faktet e parashtruara në dokumentin e DSIK-së plotësojnë rrethanat e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se çështjet e trajtuara nga Komisioni si rrethana të cilat e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm sa i përket kriterit të kontrollit të figurës, nuk parashikohen nga ligji nr. 84/2016 si shkaqe që e bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës lidhur me këtë kriter, por edhe elementet e këtyre çështjeve nuk janë të vlefshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në konkluzionet e mëposhtme.

I. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 102,94 m², ndodhur në Elbasan, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, pasi rezultoi e provuar se ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në vitet 2013, 2014. Si rrjedhojë e kësaj situatë faktike, në përputhje me kërkesat e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, faktet e çështjes krijojnë bindjen për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Fatmir Lushi ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuar nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.

II. Në përfundim, Kolegji, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çmon se vendimi i Komisionit nr. 125, datë 26.03.2019, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 125, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, më datë 08.09.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne – gjyqtaret Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses, dhe Rezarta Schuetz, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues – jemi dakord me vendimin nr. 20, datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 125, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi. Mendimi ynë paralel lidhet me një pjesë të zgjidhjes përfundimtare. Nga shqyrtimi i çështjes në Kolegj në dhomë këshillimi, ka rezultuar, ndër të tjera, se DSIK-ja, në raportet e saj për vitet 2017-2018 dhe 2019, ka vlerësuar se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi cenon drejtpërdrejt pastërtinë e figurës, çka përbush përcaktimin e germës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016. Po nga këto raporte, sipas grupit të punës është konfirmuar konstatimi për papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, ndaj subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.
2. Këto raporte, në përmbajtjen e tyre, bazohen në disa procedime penale në të cilat subjekti i rivlerësimit ka qenë i përfshirë kur ka ushtruar detyrën e prokurorit përkatësisht pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këto procedime penale janë ngritur dyshime të arsyeshme që subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht në atë të korrupsionit aktiv dhe pasiv për shkak të funksionit, duke i favorizuar personat në procedim.
3. Sipas raporteve: “[...] situata pasqyron korrupsionin sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, pasi subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit [...], ka dyshime të arsyeshme që është përfshirë në veprime korruptive, [...] veprimtari e paligjshme, i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen vepra penale sipas nenit 75 të Kodit të Procedurës Penale “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.
4. Në dritë të sa më sipër, Komisioni ka administruar dosjet penale që u përkasin këtyre çështjeve, në të cilat janë bazuar raportet e DSIK-së lidhur me kriterin e kontrollit të figurës. Nga analiza dhe hetimi që ka kryer Komisioni, ka rezultuar se faktet që janë përdorur në këto raporte të DSIK-së, përputhen me rrethanat që u përkasin këtyre procedimeve penale. Në njërin procedim penal është vendosur pushimi dhe është konstatuar se hetimi ishte jo i plotë nga ana e prokurorit, kurse në tjetrin procedim penal ka rezultuar se prokurori [subjekti i rivlerësimit] nuk ka kryer hetim të plotë të çështjes, duke hequr një akuzë ndaj personit që procedohej (shih faqen 7 të vendimit të Komisionit.) Sipas vendimit të Komisionit, për të verifikuar më tej këto fakte, trupi gjykues së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar, kanë verifikuar dokumentacion e klasifikuar dhe, pasi kanë analizuar dokumentacionin për sa i përket kriterit të kontrollit të figurës, kanë krijuar bindjen se faktet që janë përdorur në raportet e DSIK-së, janë të vërteta.
5. Në përfundim të hetimit administrativ, pasi dëgjoi edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në funksion të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, nga vlerësimi tërësor i fakteve dhe rrethanave, të lidhura me përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive përmes favorizimit të çështjeve penale të hetuara, raportit të DSIK-së, të dhënave të besueshme, si dhe bindjes së brendshme, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
6. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, shumica e trupit gjykues të Kolegjit, konstaton se:

[...] këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, por duke analizuar aftësitë profesionale të subjektit, pasi në raportin e DSIK-së rezultoi se disponohen të dhëna, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Shkodër. Në këtë kontekst, është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale [...].

7. Pikërisht në këtë konkluzion të shumicës së trupit gjykues, ndajmë mendimin tonë të ndryshëm. Ndërsa Komisioni ka vendosur vetëm bazuar në kriterin e kontrollit të figurës dhe atij të pasurisë, fakti që ka rezultuar nga Komisioni, shtjelluar në faqen 10 të vendimit, ka qenë orientuar drejt cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
8. Ndodhur në këtë situatë, çmojmë se trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet arsytimit të vendimit, duhet të kishte konstatuar se me veprimet e tij në ushtrimin e detyrës, subjekti kishte pasqyruar qëndrime të cilat, minimalisht në këndvështrimin e një vëzhguesi objektiv, pasqyrojnë qasje, sjellje dhe mosveprime të cilat passjellin mungesë besimi të sistemi i drejtësisë. Të tilla, ndër të tjera, në vlerësimin tonë, janë rrethanat e vërejtura në njërin nga çështjet ku subjekti i rivlerësimit, pasi parashtrou rrethana rënduese në lidhje me rrezikshmërinë e lartë të veprës penale dhe të vetë të pandehurit, me gjithë mungesën e kriterëve për zbatimin e nenit 48 të Kodit Penal, parashtrou kërkesë për zbatim të rrethanave lehtësuese gjithsesi¹⁶ në inkoherencë me vetë qëndrimin e tij, apo rrethanat që lidhen me mosveprimet e subjektit në funksion të hetimit të plotë e të saktë dhe kryerjes së veprimeve verifikuese për hetime nga prokuroritë e tjera në një çështje tjetër¹⁷.
9. Duke pasur parasysh që vendimi i Komisionit, sa i përket konkluzionit për cenim të besimit të publikut, bazohej dhe citonte informacionin e klasifikuar i cili mbështeste faktet e referuara në raportin mbi figurën përcjellë nga DSIK-ja, jemi të mendimit që trupi gjykues duhet të konstatonte këto fakte dhe, duke korrigjuar dhe orientuar Komisionin, të binte dakord me konkluzionin përfundimtar si më sipër. Ky qëndrim i yni është në përputhje me rolin e Kolegjit për të korrigjuar gabimet e kryera nga Komisioni, parashikuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që në zgjidhjen e çështjeve të tjera të ngjashme, Komisioni të vlerësojë me kujdes të gjitha aspektet e kriterëve mbi të cilat procedon gjatë hetimit administrativ apo vendos masën disiplinore për subjektet. Shumica e trupit gjykues të Kolegjit e ka fokusuar vendimin vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka gjetur që, pavarësisht problematikave potencialisht të rëndësishme, nuk ka vend për të

¹⁶ Shih faqen 7 të vendimit të Komisionit, paragrafi 2.3 referuar procedimit penal nr. {***} të vitit 2010 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁷ Procedimi penal {***} i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

debatuar cenim të besimit të publikut, me gjithë dyshimet serioze të ngritura nga raportet e organeve ligjzbatuese.

10. Për sa më sipër, ndodhur përballë këtij gabimi të Komisionit, nën dritën e analizës së kryer në funksion të hetimit administrativ të kryer dhe informacioneve nga grupi i punës së DSIK-së, që e ka konstatuar subjektin të papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës së prokurorit, çmojmë që ishte me vend të zbatohet nga Kolegji edhe neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi